

# ADINGKOLLOR RB

*Ngjyrë për përpunim përfundimtar të pishinave, e punuar në bazë të rrëshirave sintetike dhe tretësve*

## Fusha e aplikimit:

Për përpunim përfundimtar dhe mbrojtës dekorativ, sipërfaqe me beton me armaturë ose të suvatuara, të ekspozuara në kontakt të vazhdueshëm me ujë, ndikesa atmosferike, si dhe te sipërfaqe, të cilat mirëmbahen me përdorimin e mjeteve kimike. Përdoret te pishinat, shatërvanët, akuariumet, pishinat për kultivimin e peshkut dhe objekte të ngjashme, ku konstruktionet janë në kontakt të vazhdueshëm me ujë. Gjithashtu Adingkollor RB mund të përdoret edhe për përpunim përfundimtar te elementet të ri-fabrikuara që përdoren në kontakt të drejtpërdrejtë me ujë (çezma, koritë dhe ngjashëm)

## Cilësi:

- përzierje një-komponentëshe pastoze;
- adezion i shkëlqyer për nënshtresën;
- e mbyll strukturën sipërfaqësore të nënshtresës;
- rezistent ndaj klorit, acide dhe baza të holluara, tretje të kripërave dhe vajrave minerale;
- rezistent në ndikesa atmosferike;
- rezistent ndaj ujit;
- rezistent në hollim;
- UV stabil;
- në dispozicion në më tepër ngjyra;
- aplikim i thjeshtë dhe i shpejtë;
- i lehtë për mirëmbajtje;

## Karakteristika teknike:

Cilësi	Metodë	Vlerë e deklaruar
Dukje	-	Përzierje e ngjyrosur viskoze
Dendësi	EN ISO 2811-1	(1,5 ÷ 1,7) k/m <sup>3</sup>
Kohë e tharjes në 20° C	MKC.3.C2.240	(40 – 45) min
Kohë e fortësimit në 20° C	MKC3..C2.240	(60 – 70) min
Periudhë kohore në 20° C	MKC.3.C2.240	(120-180)min
Përdorimi	-	pas 7 ditësh
Elasticitet i lyerjes	MKC.3.C2.240	Pa paraqitje të plasaritjeve dhe të qëruarit
Rezistencë ndaj akullit dhe kripërave	MKC.3.C2.240	Pa paraqitje të plasaritjeve dhe të qëruarit
Ngjeshmëri e ngjyrës	MKC.H.C8.059	Shkallë e të qëruarit "0"
Rezistencë e ngjyrës në UV rrezatim	-	Pa ndryshime

## Përgatitje e nënshtresës:

Për realizimin e përpunimit përfundimtar me Adingkollor RB, nevojitet që paraprakisht të përfundohet me të gjitha punët ndërtimore dhe të instalimit. Konstruksionet, ku realizohet përpunimi, nevojitet që të jenë të hidroizoluara, për shkak të mos-rezistencës së lyerjes në presion negativ hidrostatik. Si hidroizolim i brendshëm të konstruksioneve, rekomandohet të përdoret hidroizolim një-komponentësh në bazë çimentoje, Hidromal. Nënshtresa duhet të jetë e fortë, e thatë, e pastër, pa yndyrë, pa pluhur, pa prani të kondenzatit dhe me lagështi maksimale prej 7%. Adingkollor RB është lyerje e hollë dhe për të fituar dukje e mirë dekorative përfundimtare, nevojitet që përpunimi përfundimtar i nënshtresës të jetë i rrafshët me teksturë fine. Temperatura optimale e sipërfaqes në të cilën realizohen punimet duhet të jetë në kufijtë prej + 10° C deri + 35° C, me lagështi relative të ajrit prej 65%.

### Nënshtresë e re e betonit

Betoni duhet të ketë fjetur 28 ditë, të jetë me fortësi minimale prej 25 MPa. Lëngu i çimentos, mbetjet nga suvaja, ngjyra dhe vaji duhet të mënjanohen në mënyrë mekanike ose me përdorimin e mjeteve kimike. Nënshtresa përfundimtare duhet të pastrohet nga pluhuri me thithëse industriale pluhuri.

### Nënshtresë e vjetër e betonit

Nënshtresë e shëndoshë dhe e Pastër është parakushti kryesor për arritje të adezionit të shkëlqyer. Njëlloj si të nënshtresa e re e betonit, mënjanimi i lëngut të betonit bëhet në mënyrë mekanike. Yndyrat dhe pa-pastërtitë e depërtuara në nënshtresën duhet të mënjanohen me detergjente ose preparate speciale për atë dedikim. Nëse ekzistojnë dëmtime të nënshtresës, ato duhet të sanohen me materiale përkatëse për sanim.

### Nënshtresë me lyerje paraprake

Adingkollor RB mund të vendoset në nënshtresa me lyerje ekzistuese, vetëm nëse lyerja, që është përdorur paraprakisht është i fortë në mënyrë të mjaftueshme dhe stabile në tretës. Te këto nënshtresa, para vendosjes të lyerjes së re, patjetër duhet të shihet adezioni midis lyerjes ekzistuese dhe nënshtresës për të parë nëse këto shtresa mund të jenë nënshtresë për lyerjen e re. Nëse ky test nuk jep rezultate pozitive, atëherë shtresat e vjetra të ngjyrës patjetër duhet të mënjanohen në mënyrë mekanike. Nëse adezioni e shtresave ekzistuese është i mirë, rekomandojmë që sipërfaqet e tyre të përpunohet me zumpare, të mënjanohet pluhuri me procedurë të thatë, e mandej të bëhen fusha provuese, ku në sipërfaqe të caktuara do të vendoset shtresa e re e ngjyrës.

**Rezëk për jetën:** Prodhimet përbajnë përbërës reaktiv të cilët në gjendje të pa lidhur pjesërisht dëmshëm ndikojnë në shëndetin. Gjatë vendosjes i obligueshëm është përdorimi i pajisjes mbrojtëse: doreza, maskë dhe syze. Nevojitet që të shmangët kontakt i prodhimit me lëkurën. Në rast të kontaktit incidental të prodhimit me lëkurën të mënjanohet me ujë dhe sapun. Nevojitet të shmangët kontakti i prodhimit me lëkurën. Nëse materiali spërkatë në sy, nevojitet që ato menjëherë të shpëlahen me shumë ujë dhe të kërkohet ndihmë mjekësore. Nëse gjëllitet, nevojitet që menjëherë të kërkohet ndihmë mjekësore.

**Zjarr:** Adingkollor-RB dhe Rastvoruvaç-P përbajnë tretës që mund të ndizen. Nuk duhet të përdoren afër zjarrit të hapur ose të pihet duhan gjatë vendosjes.

**Pastrimi dhe vendosja në depo:** Mbetjet e palidhura të Adingpoks – 1B EKO pastrohen me Rastvoruvaç P. Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullativave lokale për atë lloj të mbetjeve. Rekomandojmë që mënyra e vendosjes dhe sasia e nevojshme të përshtatet në kushtet e objektit, si dhe me përdorim të domosdoshëm të pajisjes përkatëse.

## Vendosje:

Vendosja e Adingkollor RB bëhet me furçë, cilindër ose me makinë, me spërkatje me pompë pa ajër (airless), në 2 deri 3 shtresa, me trashësi të thatë të shtresës prej 150-200µ. Për vendosje të shtresës së parë, materiali hollohet me 8-10% Rastvoruvaç P, me ç'rast masa përzihet me përzjerje të ngadalshëm deri në homogjenizimin e plotë. Gjatë hollimit të materialit, duhet të kihet kujdes që sasia e cila do të hollohet ti përgjigjet sasisë së nevojshme për një shtresë të sipërfaqes e cila përpunohet. Shtresa e dytë dhe e tretë vendoset pas hollimit deri 8%. Distanca kohore e aplikimit midis shtresave, në temperaturë prej 20° C është 3-4 orë. Sipërfaqet e punuara duhet të mbrohen nga shkujë e fuqishme, shi, akull dhe pluhur në periudhë prej 12 orëve. Temperatura e nënshtresës gjatë aplikimit duhet të jetë më e lartë se 5° C.

### Vendosje makinerike me pompe pa ajër

-presioni (150-200) bar

-diznë (pipëz spërkatëse) 6.35; 7.45; 8.45

-këndi i spërkatjes: në kënd të drejtë në raport me nënshtresën

## Mirëmbajtje:

Jetëgjatësia e lyerjes varet nga mënyra e përdorimit dhe mirëmbajtjes. Lyerja me Adingkollor RB, mund të pastrohet edhe me makina me furça të buta rrotulluese, me detergjente të tretura në ujë dhe me acide të holluara.

## Shpenzimi:

për dy shtresa

0,50 deri 0,60 kg/2

për tre shtresa

0,65 deri 0,80 kg/2

## Pastrimi:

Veglat dhe pajisja pastrohet me Rastvoruvaç – P menjëherë pas përdorimit.

## Paketimi:

Govata teneqeje prej 4 dhe 20 kg

## Vendosja në depo:

Në ambalazh origjinal, të mbyllur, në temperaturë prej 5°C deri 35°C. Afati i përdorimit : 9 muaj.

## Ngjyra standarde:

RAL 5012; RAL 5015; RAL 5018; RAL 5022; RAL 502; RAL 9003.

**Vërejtje:** RAL ngjyrat e tjera mund të përgatiten në rast të porosisë minimale prej 90 kg.